



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 238 Prot

Maliq, më 15.06.2023

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së parë të këshillit të bashkisë Maliq
Z. / Znj. (Këshilltar i mandatura nga KQZ)

I nderuar z./znj. (Këshilltar i mandatura nga KQZ)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 48, "Mbledhja e parë e këshillit", pika 1, pika 2, pika 5 dhe 6, ju njoftojmë se mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e këshillit ditën e, **hënë më datë 19.06.2023, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

- 1 Konstituimi i këshillit bashkiak dhe zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese.
 - 1.1 Konstituim i këshillit bashkiak
 - Zgjedhja e komisionit të mandateve;
 - Verifikimi i mandateve dhe miratimi i mandateve të antarëve të këshillit bashkiak;
 - Betimi i këshilltarëve.
 - 1.2 Zgjedhja e kryetarit të këshillit
 - Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - Zgjedhja e komisionit të votimit, si rregull 3 antarë;
 - Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e kryetarit të këshillit bashkiak;
 - 1.3 Zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të këshillit bashkiak:
 - Miratimi me votim i numrit të zëvendëskryetarëve të këshillit bashkiak;
 - Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të këshillit bashkiak.
2. Zgjedhja e përfaqësuesit të këshillit të bashkisë në këshillin e qarkut.
3. Ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës së kryetarit të bashkisë.
 - a. Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë .
 - b. Kryerja e betimit të kryetarit të bashkisë.

Ju faleminderit!

SEKRETAR I KËSHILLIT

Gertjan GJIRTI

